

Asseco SEE SH.P.K.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8 - 22

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe aksionarin e ASSECO SEE sh.p.k.

Raporti mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Asseco SEE sh.p.k. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë bilancin kontabël më 31 dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethanat e caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Asseco SEE sh.p.k. më 31 dhjetor 2013 si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

26 mars 2014

Tiranë, Shqipëri

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited


Nuriona Sokoli Berdica
Partner Angazhimi

Asseco SEE SH.P.K.
 Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2013
 (Të gjitha shumat janë në LEK)

Shënime	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Aktivet		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	3 4,675,962	3,939,127
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	4 277,540	277,540
Totali i aktiveve afatgjata	4,953,502	4,216,667
Aktivet afatshkurtra		
Inventari	5 5,796,614	5,777,449
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	6 22,379,706	16,580,800
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7 40,383,254	59,427,212
Tatimi aktual	10 101,762	122,612
Tatimi i shtyrë	15 -	38,365
Totali i aktiveve afatshkurtra	68,661,336	81,946,438
Totali i aktiveve	73,614,838	86,163,105
Kapitali		
Kapitali aksionar	8 360,000	360,000
Rezerva ligjore	36,000	36,000
Fitimi i pashpërndarë	64,237,380	51,474,311
Totali i kapitalit	64,633,380	51,870,311
Detyrimet afatshkurtra		
Llogari të pagueshme dhe të tjera	9 8,981,458	34,292,794
Totali i detyrimeve afatshkurtra	8,981,458	34,292,794
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	73,614,838	86,163,105

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Drejtimi i Asseco SEE sh.p.k. më 25 mars 2014 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:


 Ardian SHEHU
 Administrator



Asseco SEE SH.P.K.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në LEK)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shitjet	11	84,998,794	99,514,363
Kosto e mallrave të shitura	12	(35,812,303)	(52,231,994)
Shitjet neto		49,186,491	47,282,369
Të ardhura të tjera		781,486	289,035
Shpenzime administrative	13	(35,507,347)	(38,168,690)
Shpenzime të tjera operative		-	(364,798)
Fitimi operativ		14,460,630	9,037,916
(Shpenzime) / të ardhura financiare, neto	14	(76,782)	129,460
Fitimi para tatimit		14,383,848	9,167,376
Shpenzime për tatim fitimin	15	(1,620,779)	(1,162,439)
Fitimi neto i vitit		12,763,069	8,004,937

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Asseco SEE SH.P.K.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në LEK)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitim i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2011	360,000	36,000	43,469,374	43,865,374
Transferim i rezervës	-	-	-	-
Rritja e rezervës	-	-	-	-
Fitimi neto i vitit	-	-	8,004,937	8,004,937
Gjendja më 31 dhjetor 2012	360,000	36,000	51,474,311	51,870,311
Transferim i rezervës	-	-	-	-
Rritja e rezervës	-	-	-	-
Fitimi neto i vitit	-	-	12,763,069	12,763,069
Gjendja më 31 dhjetor 2013	360,000	36,000	64,237,380	64,633,380

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Asseco SEE SH.P.K.

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në LEK)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Para të arkëtuara nga klientët	97,709,195	133,200,958
Para paguar furnitorëve	(73,947,026)	(56,909,741)
Para paguar punonjësve dhe sigurimeve shoqërore	(23,291,593)	(20,340,321)
Pagesa të tjera, neto	(17,885,849)	(21,879,082)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	(17,415,273)	34,071,814
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(1,628,685)	(1,731,182)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	(1,628,685)	(1,731,182)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Interesi i paguar	-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese	-	-
(Rënia) / Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj	(19,043,958)	32,340,632
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7 59,427,212	27,086,580
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	7 40,383,254	59,427,212

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Asseco SEE Sh.p.k. ("Shoqëria") u themelua në 30 prill 2007 si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare që veprojnë në Shqipëri. Zyrat e saj qendrore ndodhen në Tiranë.

Gjatë vitit 2010 Shoqëria përthithi Pexim sh.p.k., që më parë zotërohej nga Asseco See Sh.p.k., sipas vendimit të aksionarëve më 25 nëntor 2010.

Kapitali i Shoqërisë më 31 dhjetor 2013 prej 360,000 LEK zotërohet plotësisht nga "ASSECO SEE" sh.p.k, Prishtinë, Kosovë.

Shoqëria u themelua për qëllime të ofrimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit si dhe për zhvillimin dhe vënien në zbatim të software-ave në Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria kishte 9 punonjës (2012: 7 punonjës).

2. Përmbledhje e politikave bazë kontabël

(a) Deklarat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare bashkëngjitur janë të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

(b) Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike. Shumat në pasqyrat financiare janë të shprehura në monedhën shqiptare Lek (LEK), që është edhe monedha e vendit në të cilën Shoqëria është themeluar.

(c) Monedhat e huaja

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë të përgatitura në LEK, e cila është monedha e mjedisit ekonomik në të cilin Shoqëria vepron.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedhë e huaj) konvertohen në LEK me kursin e këmbimit në ditën e transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese gjendjet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të asaj date. Gjendjet jo-monetare, që maten me kosto historike dhe që mbahen në monedhë të huaj, nuk konvertohen.

Diferencat që vijnë si rezultat i konvertimit njihen në humbje ose në fitim në periudhën në të cilën lindin.

Kurset e këmbimit në LEK të monedhave kryesore të përdorura për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare në 31 dhjetor 2013 dhe 2012 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Dollari amerikan (USD)	101.86	105.85
Monedha e Bashkimit European (EUR)	140.20	139.59

2. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(d) Inventari

Inventari njihet fillimisht me kosto historike dhe në vijim vlerësohet me më të voglën mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes për njësi i zvogëluar me koston e ndryshueshme të shitjes. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën FIFO dhe përbëhet nga kosto e blerjeve dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta të lidhura me sjelljen e inventarin në gjëndjen aktuale.

(e) Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Elementët e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe rënie në vlerë, nëse ka të tillë.

Blerja e programeve kompjuterike (software), të cilët janë thelbësorë në funksionimin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Pjesë të ndryshme të një aktivi afatgjatë material, të cilat kanë afate të ndryshme përdorimi, kontabilizohen si zëra të veçanta të aktiveve.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi i ngarkohet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me Legjislacionin Shqiptar duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

Normat e përdorura të zhvlerësimit janë si më poshtë:

<u>Kategoria e aktivitet</u>	2013	2012
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje zyre	20% - 25%	20% - 25%

2. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(f) Instrumentat financiarë

Shoqëria i njeh fillimisht llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën në të cilën ato krijohen. Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e transaksionit kur Shoqëria bëhet palë e kontraktimit të instrumentit. Shoqëria e regjistron një aktiv financiar kur skadon e drejta e kontraktuar ndaj flukseve monetare të aktivit, ose kur ajo i transferon të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin transferohen në mënyrë thelbësore të gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia mbi aktivin financiar. Çdo interes nga një aktiv financiar i transferuar, i cili është krijuar apo ruajtur nga Shoqëria, regjistrohet si një aktiv ose detyrim më vete. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet në bilancin kontabël, vetëm në rastin kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar vlerat dhe ka për qëllim ose ta paraqesi mbi baza neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme dhe të tjera, paranë dhe ekuivalentët e saj dhe llogari të pagueshme dhe të tjera.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogari rrjedhëse.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo humbje nga rënia në vlerë.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me vlerën e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumentat e tjera financiare jo-derivative maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, zbritur cdo humbje nga zhvlerësimi.

(g) Rënia në vlerë

i. Aktivet financiare

Aktivët financiarë, të cilët nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes humbjes ose fitimit, vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues objektiv për rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet të jetë zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se, një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, kanë pasur një ndikim në rrjedhën e pritshme të mjeteve monetare të aktivit financiar, të cilat mund të maten në mënyrë të besueshme.

2. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(g) Rënia në vlerë (vazhdim)

i. Aktivet financiare (vazhdim)

Humbja nga rënia në vlerë e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare, të cilat janë të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe mbahen në një llogari provigjoni, që zvogëlon llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton uljen e rënies në vlerë, zvogëlimi i rënies në vlerë regjistrohet përmes humbjes ose fitimit.

ii. Aktivet jo-financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare për të përcaktuar nëse ka tregues për rëniet e vlerës. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen përmes humbjes ose fitimit.

(h) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal operativ, kryen pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar në sigurimet shoqërore të detyrueshme, bazuar në legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera në emër të Shoqërisë regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

(i) Qira operative

Pagesat e bëra për qira operative njihen dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në një bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë.

(j) Të ardhura financiare dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimin nga kurset e këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi nga huatë, humbje nga kurset e këmbimit dhe rënia në vlerë e njohur në lidhje me aktivet financiare.

Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.



2. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(k) Shpenzime për tatimin mbi fitimin

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin e periudhës përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimet për tatim fitimin njihen përmes humbjes ose fitimit, me përjashtim të rasteve kur ai lidhet me zëra të njohur direkt në kapitalet e veta. Në këto raste tatimi njihet gjithashtu në kapital.

Detyrimi aktual për tatim fitimin është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën e tatimit të dekretuar, ose pjesërisht të dekretuar në datën e raportimit dhe çdo tatim të pagueshëm në lidhje me vitet paraardhëse.

Tatim-fitimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, mbi diferenca të përkohëshme që lindin nga baza tatimore e aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së tyre kontabël të mbartur në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë matet me norma tatimore që pritet të aplikohen mbi diferencat e përkohëshme kur ato rimerren, bazuar mbi ligjet tatimore të dekretuara, ose pjesërisht të dekretuara në datën e raportimit.

Aktivi tatimor i shtyrë njihet deri në atë masë për të cilën ekziston mundësia që do të ketë disponibilitet të fitimeve të ardhshme të tatueshme, përkundrajt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohëshme. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet deri në masën kur përfitimet përkatëse tatimore nuk do të realizohen.

Detyrimi tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohëshme të tatueshme.

(l) Të ardhura

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në pasqyrat financiare kur titulli i pronësisë, rreziqet e lidhura dhe përfitimet janë transferuar nga shitësi te blerësi.

E ardhura nga shitja e shërbimeve njihet në pasqyrat financiare duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese, kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri. Për matjen me besueshmëri të rezultatit të një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri,
- Ekziston mundësia që përfitimet ekonomike të lidhuara me transaksionin do të arkëtohen nga njësia ekonomike,
- Faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës së raportimit mund të matet në mënyrë të besueshme,
- Dhe kostot e ndodhura për transaksionin dhe kostot që priten të ndodhin për përfundimin e transaksionit të mund të maten në mënyrë të besueshme.



2. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(m) Transkasionet me palët e lidhura

Një palë konsiderohet e lidhur nëse: (a) direkt, ose indirekt, nëpërmjet një ose disa ndërmjetësve, pala: (i) kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontrollin e përbashkët me njësinë ekonomike, (ii) ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike; (b) pala është një pjesëmarrje; (c) pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; (d) pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj; (e) pala është një familjar i afërt i ndonjë prej individëve referuar pikës (a) ose (d); (f) pala është një njësi ekonomike që kontrollohet, bashkëkontrollohet apo me ndikim të rëndësishëm, ose për të cilën ruan fuqinë më të madhe të votimit, direkt apo indirekt për çdo individ të referuar në (d) ose (e); ose (g) pala është një skemë e përfitimit pas – punësimit për përfitimin e punonjësve të njësisë ekonomike. Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve, pavarësisht nëse është vënë një çmim.



Asseco SEE SH.P.K.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Aktivet afatgjata materiale

<i>Kosto</i>	Mjete transporti	Pajisje zyre	Totali
Gjendja më 1 janar 2012	2,340,253	2,885,360	5,225,613
Shtesa	1,597,924	133,544	1,731,468
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2012	3,938,177	3,018,904	6,957,081
 Shtesa	 1,614,486	 14,200	 1,628,686
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	5,552,663	3,033,104	8,585,767
 <i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2012	1,002,991	1,140,559	2,143,550
Zhvlerësimi i vitit	457,024	417,380	874,404
Gjendja më 31 dhjetor 2012	1,460,015	1,557,939	3,017,954
 Zhvlerësimi i vitit	 552,596	 339,254	 891,850
Gjendja më 31 dhjetor 2013	2,012,611	1,897,193	3,909,804
 <i>Vlera e mbetur</i>			
Më 1 janar 2012	1,337,262	1,744,801	3,082,063
Më 31 dhjetor 2012	2,478,163	1,460,965	3,939,127
Më 31 dhjetor 2013	3,540,052	1,135,911	4,675,963

4. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari të arkëtueshme nga Asseco SEE	277,540	277,540
TOTALI	277,540	277,540

Kjo shumë përfaqëson vlerën e kapitalit të shtuar, e cila do të financohet nga aksionari i Shoqërisë.

5. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Mallra për shitje	5,796,614	5,777,449
Mallra për t'u dhënë me qira	-	-
TOTALI	5,796,614	5,777,449

Inventari konsiston në pajisje elektronike që përdoren nga Shoqëria gjatë aktivitetit normal, si për shembull ATM-të, skanera, printera, lexues kartash, etj.

Ky inventar do përdoret nga Shoqëria në përmbushjen e kontratave ekzistuese të shitjeve dhe mirëmbajtjes gjatë vitit 2014 e në vijim.

6. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari të arkëtueshme	14,506,355	14,580,550
Të ardhura të përlllogaritura nga shërbimet	7,714,060	1,840,958
Aktive të tjera afatshkurtra	159,292	159,292
TOTALI	22,379,706	16,580,800

Llogari të arkëtueshme përfshijnë vlera të arkëtueshme nga klientët për shitjen e mallrave dhe shërbimeve dhe të cilat lidhen me fatura ende të papaguara, të lëshuara gjatë muajve të fundit të vitit.

Nën të ardhurat e përlllogaritura nga shërbimet për vitin 2013 përfshihen shërbimet e ofruara njërit prej klientëve, Societe Generale Albania për të cilin nuk janë lëshuar fatura përkatëse (2012: shërbime të ofruara ndaj Devolli Hydropower).

7. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Ekuivalenti në LEK i parasë dhe ekuivalentëve të saj në LEK dhe monedha të tjera më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Paraja në arkë	66,256	18,550
Në LEK	5,549	10,593
Në EUR	60,707	7,957
Paraja në bankë	40,316,998	59,408,662
Në LEK	5,466,738	6,314,460
Në USD	-	7,492,864
Në EUR	34,850,260	45,601,338
TOTALI	40,383,254	59,427,212

8. Kapitali aksionar*Kapitali i regjistruar*

	2013	2012
Më 1 janar	346,120	346,120
Përthithja e Pexim sh.p.k.	-	-
Transferimi i rezervës	13,880	13,880
Më 31 dhjetor	360,000	360,000

Gjatë vitit 2010 aksionari i Asseco SEE sh.p.k. vendosi që Shoqëria të përthithi një shoqëri tjetër, Pexim sh.p.k., bazuar në vendimin më datë 25 nëntor 2010. Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 kapitali aksionar përbëhet nga 360 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek secili.

9. Llogari të pagueshme dhe të tjera

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	4,419,391	24,190,477
Tatime të tjera të pagueshme	2,218,932	2,819,967
Të pagueshme ndaj personelit	1,514,228	3,971,818
Të pagueshme ndaj furnitorëve	629,736	597,700
Detyrime për sigurimet shoqërore	199,171	626,183
Të ardhura të shtyra – Banka Intesa SanPaolo	-	2,086,650
TOTALI	8,981,458	34,292,795

9. Llogari të pagueshme dhe të tjera (vazhdim)

Shuma e paraqitur nën zërin e llogarive të pagueshme me palët e lidhura i referohet furnizimeve normale të marra nga palët e lidhura në Serbi gjatë aktivitetit operacional të Shoqërisë.

Detyrimet e tjera tatimore përbëhen kryesisht nga tatimi i pagueshëm mbi vlerën e shtuar.

10. Tatimi aktual

Tatimi aktual përfaqëson tejkalimin e parapagimeve për tatim fitimin e vitit mbi detyrimin e llogaritur për tatim fitimin (2012: Tatim fitimi i parapaguar).

Një rakordim i tatimit aktual të arkëtueshëm për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012, është si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Parapagime të akumuluar për tatim fitimin gjatë vitit	1,684,176	1,573,867
Rregullime nga vitet e kaluara (shënimi 15)	-	-
Tatim fitimi i pagueshëm për vitin (shënimi 15)	(1,582,414)	(1,451,255)
Tatim fitimi i parapaguar	101,762	122,612

11. Të ardhurat nga shitjet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura nga shërbimet	80,339,643	77,457,348
Shitja e mallrave	4,659,151	22,056,015
TOTALI	84,998,794	99,514,363

12. Kosto e mallrave të shitura

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shërbime dhe produkte të blera	35,812,302	52,231,994
TOTALI	35,812,302	52,231,994

13. Shpenzime administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Pagat	17,541,550	19,276,246
Shërbime të konsulencës	7,500,904	8,784,589
Qiratë	2,823,578	2,844,021
Udhëtime dhe dieta	1,440,166	870,508
Furnizime	1,277,072	1,779,992
Naftë dhe të tjera	1,089,240	1,045,579
Zhvlerësimi	891,850	874,886
Shpenzime telefoni	788,119	800,777
Komisione bankare	345,327	261,311
Sigurimet	133,436	131,479
Taksa	-	15,120
Shpenzime të tjera	1,676,107	1,484,183
TOTALI	35,507,348	38,168,690

Shpenzimet e tjera përbëhen nga shërbime noterie, shpenzimet për reklama, shpenzime shtesë, etj.

14. (Shpenzime) / të ardhura financiare neto

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Fitimet / (humbjet) neto nga kurset e këmbimit	(101,667)	110,912
<i>Fitimi nga kurset e këmbimit</i>	<i>1,787,360</i>	<i>1,512,529</i>
<i>Humbja nga kurset e këmbimit</i>	<i>(1,889,027)</i>	<i>(1,401,617)</i>
Të ardhurat nga interesat	24,885	18,548
<i>Të ardhura nga interesat</i>	<i>28,862</i>	<i>20,592</i>
<i>Shpenzime nga interesat</i>	<i>(3,977)</i>	<i>(2,044)</i>
TOTALI	(76,782)	129,460

15. Shpenzime për tatim fitimin

Paraqitja e mëposhtme është një rakordim i normës efektive të tatimit dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Fitimi i vitit		
Fitimi kontabël	14,383,848	9,167,376
Shpenzime të pazbritshme	1,814,855	1,631,924
Efekti i shpenzimeve të zbritshme në periudha të tjera	-	(610,242)
Efekti i të ardhurave të tatueshme në periudha të tjera	(374,560)	4,323,497
Fitimi i tatueshëm	15,824,143	14,512,555
Norma efektive e tatimit	10%	10%
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	1,582,414	1,451,255
Shpenzime / (Përfitime) nga tatimi i shtyrë	38,365	(288,816)
Totali i shpenzimit për tatimin mbi fitimin	1,620,779	1,162,439

Të ardhurat e tatueshme në periudha të tjera lidhen me të ardhura të pafaturuara të njohura për qëllime financiare në përputhje me SKK 8 Të ardhurat dhe të përfshira në llogaritjen e fitimit kontabël. Megjithatë, përderisa faturat tatimore për këto shërbime do të lëshohen në periudha të tjera, tatimi i lidhur me to është shtyrë në periudhat e ardhshme në përputhje me SKK 11 Tatim Fitimi.

Nuk ka tatim të shtyrë aktiv apo detyrim më 31 dhjetor 2013 (më 31 dhjetor 2012 tatim fitimi i shtyrë aktiv u llogarit duke pasur parasysh diferencat e zbritshme për detyrimet të cilat do të konsideroheshin të zbritshme në llogaritjen e fitimit të tatueshëm për 2013).

Një rakordim i (detyrimit) / aktivitetit tatimor të shtyrë më 31 dhjetor 2013 dhe 2012, është si vijon:

	2013	2012
Më 1 janar	38,365	(250,451)
Rregullime nga vitet e kaluara (shënimi 10)	-	-
(Shpenzime) / Përfitime nga tatimi i shtyrë	(38,365)	288,816
Tatim i shtyrë aktiv	-	38,365

16. Transaksionet me palët e lidhura

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura është si më poshtë:

Bilanci kontabël	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Aktivet		
Të arkëtueshme nga Asseco SEE	277,540	277,540
Të arkëtueshme nga palë të tjera të lidhura	7,543,171	-
Totali i të arkëtueshmeve nga palët e lidhura	7,820,711	277,540
Detyrimet		
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	4,419,391	24,190,477
Totali i të pagueshmeve ndaj palëve të lidhura	4,419,391	24,190,477
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shitje ndaj palëve të lidhura	24,814,458	6,601,960
Blerje nga palët e lidhura	34,224,436	29,634,292

Blerjet nga palët e lidhura përbëhen kryesisht nga shërbime të marra.

17. Angazhimet dhe pasiguritë

Nuk ekzistojnë angazhime dhe pasiguri më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

18. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka pasur asnjë ngjarje pas datës 31 dhjetor 2013, e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.

19. Manaxhimi i rrezikut financiar**a) Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normës së interesit konsiston në rrezikun që vlera e instrumentit financiar do të variojë si pasojë e ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe në rrezikun që maturitetet e aktiveve të cila mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve të cila mbartin interes, të cilat përdoren për të financuar aktivet në fjalë. Periudha kohore për të cilën norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse rrjedhimisht tregon se sa është ky mjet i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

b) Rreziku i kreditit

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndjeshëm ndaj rrezikut të kreditit në mënyrë të tillë që mund të ndikojë pozicionin e saj financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

c) Rreziku i likuiditetit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 si më poshtë:

	Shuma në pasqyrat financiare	3 muaj ose më pak	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
31 dhjetor 2013					
<i>Aktivet financiare</i>					
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	277,540	-	-	277,540	-
Llogari të tjera të arkëtueshme	14,506,355	10,473,288	3,535,092	497,975	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj	40,383,254	40,383,254	-	-	-
Aktive tatimore	101,762	101,762	-	-	-
Totali	55,268,911	50,958,304	3,535,092	775,515	-
<i>Detyrimet financiare</i>					
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	8,981,458	8,738,163	-	243,295	-
Totali	8,981,458	8,738,163	-	243,295	-
Hendeku i likuiditetit	46,287,453	42,220,141	3,535,092	532,220	-

19. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

<i>31 dhjetor 2012</i>	Shuma në pasqyrat financiare	3 muaj ose më pak	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
<i>Aktivet financiare</i>					
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	277,540	-	-	277,540	-
Llogari të tjera të arkëtueshme	16,580,800	11,982,685	4,496,097	102,018	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj	59,427,212	59,427,212	-	-	-
Aktive tatimore	160,978	160,978	-	-	-
Totali	76,446,530	71,570,875	4,496,097	379,558	-
<i>Detyrimet financiare</i>					
Tatimi aktual					
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	34,292,794	32,553,634	1,570,858	168,302	-
Totali	34,292,794	32,553,634	1,570,858	168,302	-
Hendeku i likuiditetit	42,153,736	39,017,241	2,925,239	211,256	-

20. Paraqitjet dhe vlerësimet e vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në instrumentat financiare të bilancit kontabël pa vlerësuar pritshmërinë mbi të ardhmen e biznesit dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve jo të konsideruara si instrumenta financiare.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përaftron vlerën e tyre të mbartur në bilancin kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose normave përkatëse të interesit, të cilat janë të përafërta me normat e tregut.